



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO	KOMUNA E SHTIMES/OPSTINA ŠTILJE
Nr i Proces/Prot	02/11
Nr i Faqeve/Bр.strana	5
Data/Data:	16. 02. 2023
SHTIME/ŠTILJE	

16.02.2023

02/56

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

në mes të

Komunës së Shtimes

dhe

CNVP (Connecting Natural Values and People Foundation)

lidhur me

Prodhimin dhe shfrytëzimin e biomasës, planifikimin dhe menaxhimin e cilësisë për sistemin e ngrohjes qendrore me biomasë

Hyrje

Fondacioni CNVP në Kosovë është duke zbatuar projektin “Përdorimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore për Mjediset dhe Zhvillim Ekonomik (SUNREED)”, të financuar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë/ Sweden International Development Aid (Sida) (2022-2026)

Projekti “SUNREED” që lidhet me mjedisin dhe ndryshimet klimatike, njerëzit që jetojnë në varfëri, barazinë gjinore dhe perspektivën e konfliktit, do të mbështesë drejtpërdrejt Pronarët e Pyjeve Private (PPP) dhe shoqatat e tyre te cilat veprojnë në 23 komuna si dhe Asociacionin Kombëtar të Pronarëve të Pyjeve Private (AKPPP) për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve të tyre. Kjo do të bëhet përmes inkurajimit të drejtpërdrejtë dhe mbështetjes për përmirësimin e menaxhimit të pyjeve, në zhvillimin e Produkteve Pyjore Jo-Drunore (PPJD-te), Bimëve Mjekësore Aromatike (BMA-te) dhe sistemeve të prodhimit të biomasës, duke kontribuar në përmirësimin e politikave dhe legjislacionit, si dhe në gjenerimin e të ardhurave për Pronarët e Pyjeve Private (PPP).

Neni 1 - Arsyeshmëria

Ky memorandum është rezultat i diskutimeve dhe propozimeve për bashkëpunim, të iniciuara gjatë takimeve ndërmjet përfaqësuesve të Komunës së Shtimes dhe CNVP-së në kuadër të projektit "Perdorimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore për Mjedis dhe Zhvillim Ekonomik" dhe ofrimin e praktikave të mira të pylltarisë dhe biomasës drusore.

Neni 2 – Qëllimi

Qëllimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Shtimes dhe Fondacionit CNVP është bashkëpunimi dhe kordinimi i aktiviteteve për prodhimin dhe shfrytëzimin e biomasës së drurit si dhe menaxhimin e cilësisë për sistemin e ngrohjes qendrore me biomasë.

Neni 3 – Fushëveprimi i bashkëpunimit

Ky memorandum mbulon bashkëpunimin ndërmjet Komunës së Shtimes dhe CNVP-së në aktivitetet përgatitore, aktivitetet organizative dhe mbledhjen e informacionit për përgatitjen dhe finalizimin e koncept dokumentit (project propozimit) për prodhimin dhe përdorimin e biomasës së drurit si dhe menaxhimin e cilësisë për systemin e ngrohjes me biomasë.

Neni 4 – Aktivitetet (Obligimet) e Komunës së Shtimes të pajtuara me këtë memorandum

Komuna do të sigurojë disponueshmerinë e një informacioni të nivelit të mjaftueshëm dhe cilësor që do të përdoret për nevojat e zbatimit të aktiviteteve të projektit.

Komuna do të:

- Cakton një zyrtar përgjegjës (koordinator) për zbatimin e aktiviteteve për përgatitjen e koncept dokumentit (project propozimit);
- Ofron informacionin përkatës për hartimin e koncept dokumentit (project propozimit);
- Garanton pjesëmarrjen e anëtarëve të grupit punues dhe përfaqësuesve tjerë komunal në punëtoritë dhe takimet që do të organizohen për përgatitjen dhe diskutimin e konceptit;
- Jep komente, amendamente dhe propozime për finalizimin e koncept dokumentit;
- Përgatit propozimin dhe ia përcjell institucioneve financuese;

Neni 5 - Aktivitetet (Obligimet) e CNVP-së të pajtuara me këtë memorandum

- Cakton një pikë kontakti që do të angazhohet në aktivitete dhe do të jetë person kontaktues për Komunën;
- Mbështet komunën në mbledhjen e informatave relevante për finalizimin e koncept dokumentit (projekt propozimit) për sistemin e ngrohjes bazuar në biomasë druri;
- Mbështet përgatitjen e koncept dokumentit;
- Ofron mbështetje teknike dhe logistike në organizimin e punëtorive dhe takimeve me grupin punues dhe përfaqësuesit tjerë komunal në punëtori për përgatitjen dhe diskutimin e konceptit;
- Kontribuon në koncept me të dhënat dhe propozimet që rrjedhin nga procesi i diskutimeve dhe konsultimeve për finalizimin e dokumentit;
- Mbështet komunën në përgatitjen e dokumentit përfundimtar për procedim tek institucionet financuese.

Neni 6 – Menyra e bashkëpunimit

Për zbatimin e qëllimit dhe aktiviteteve të Memorandumit, palët do të zbatojnë mënyrat dhe format e mëposhtme të bashkëpunimit:

- Mbledhja e informacionit përkatës për përgatitjen e koncept dokumentit (projekt propozimit) për sistemin e ngrohjes;
- Organizim i diskutimeve, takimeve dhe punëtorive në grupe pune;
- Analiza e dokumenteve ekzistuese si raste studimore;
- Shkëmbimi i të dhënavëve relevante përmes postës elektronike dhe formave të tjera të komunikimit;
- Zbatimi i kërkesave ligjore nga Ligji për mjedisin jetësor dhe Ligji për vetëqeverisje locale.

Neni 7 - Kordinimi

1. Secila palë, brenda 5 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij memorandumi cakton një koordinator për zbatimin e këtij Memorandumi, i cili do të jetë përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve dhe bashkëpunimit të parashikuar në nenet 3 dhe 4 të këtij MM;
2. Palët do të informojnë njëra-tjetrën në lidhje me koordinatorët përkatës të caktuar prej tyre;
3. Palët mund të zëvendësojnë koordinatorët e tyre në çdo kohë, nëse kërkohet;
4. Koordinatorët do t'i raportojnë mbikëqyrësve të tyre për zhvillimin e aktiviteteve për zbatimin e memorandumit.

Neni 8 – Pajtueshmëria ligjore

1. Ky Memorandum do të zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë;
2. Ky memorandum nuk do të cenojë të drejtat dhe detyrimet e palëve që rrjedhin nga marrëveshje të tjera.

Neni 9 – Zgjidhja e kontesteve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Memorandumit do të zgjidhet me mirëkuptim dhe konsultim të ndërsjellë ndërmjet Palëve.



Neni 10 – Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

Ky memorandum do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga të dyja palët dhe do të mbetet i vlefshëm deri në arritjen e objektivave.

Memorandumi mund të ndërpritet nëse njëra nga palët nënshkruese kërkon ndërprerjen e bashkëpunimit ose kur ky memorandum shfuqizohet me një memorandum tjetër.


Është rënë dakord në Shtime, Republika e Kosovës, më 16 shkurt 2023, në tri kopje origjinale.

Për

Komunën e Shtimes

Qemajl Aliu

Kryetarë



Për

CNVP Foundation

Xhevati Lushi

Anetarë i Bordit Ekzekutiv në CNVP

Drejtor për CNVP Kosovë